

Rreth projektit

Kjo broshurë është realizuar në kuadër të projektit "Lehtësimi i qasjes në drejtësi dhe promovimit të të drejtave të njeriut në rajonin e Mitrovicës" dhe ka për synim të rris dukshmërinë e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në veri dhe jap informacion mbi rolin dhe detajet e kontaktuese përkatëse për zyrat në rajonin e Mitrovicës.

Projekti mbështetet nga UNMIK-u dhe zbatohet nga Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC), dhe synon rritjen e kapaciteteve për promovimin e të drejtave të njeriut dhe përmirësimi i punës së institucioneve gjyqësore në veri të Kosovës.



Advocacy Center
for Democratic Culture

www.acdc-kosovo.org



Informata kontaktuese

E zyrës qendrore

Institucioni i Avokatit të Popullit Rr.
"Migjeni", nr. 21, 10000 Prishtinë
+383 (0) 38 223 782
+383 (0) 38 223 783
Puna me palë:
08:00 - 16:00

Mitrovica Veriore

Ndërtesa e Komunës së Mitrovicës
së Veriut, Lagjia e Boshnjakëve pn.
+383 (0) 45 455 319
+381 (0) 64 956 00 50
Puna me palë:
08:00 - 16:00

Mitrovica Jugore

Rr. „Afrim Zhitia“, pn.
Ndërtesa e Administratës Pensionale të
Kosovës kati III, zyra nr. 11 dhe 12
+383 (0) 28 530 138
Puna me palë:
08:00 - 16:00

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë



Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë
Institucija Ombudsmana na Kosovu
The Ombudsman Institutions of Kosovo



info.oik@oik-rks.org



www.oik-rks.org



Rreth Institucionit të Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit është mekanizëm për mbrojtjen, monitorimin, promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera që ushtrojnë autoritet publik në Kosovës.






Në të njëjtën kohë, Institucioni i Avokatit të Popullit është një mekanizëm për promovimin e barazisë, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë, pa diskriminim, në baza të mbrojtura me Ligjin për Barazinë Gjinore, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjin për Avokatin e Popullit, si dhe vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Trajtime ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese. Avokati i Popullit është institucion i të drejtave të njeriut dhe konsiderohet garanci e demokracisë dhe sistemit ligjor.

Avokati i Popullit është i pavarur në kryerjen e detyrave të tij dhe nuk pranon asnjë udhëzim apo ndërhyrje nga organet, institucionet apo autoritet e tjera. Si institucion i pavarur, ai udhëhiqet nga parimet:

- ✓ e paanësisë
- ✓ epërsisë për të drejtat e njeriut
- ✓ pavarësisë së tij
- ✓ konfidencialiteti
- ✓ profesionalizmit

Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, me qëllim të realizimit të mandatit të promovimit të të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe institucionet tjera relevante, janë rregullisht pjesë e aktiviteteve të ndryshme. Për të përmbushur mandatin e saj për promovimin, edukimin dhe ngritjen e vetëdijes për të drejtat e njeriut, organizon në vazhdimësi trajnime, tryeza të rrumbullakëta, konferenca me nxënës, studentë, punëtorë, media dhe të tjerë.

Avokati i Popullit ka juridiksion:

-  të kryejë një hetim qoftë për t'iu përgjigjur një ankesë ose me iniciativën e saj (ex officio),
-  të pranojë dhe të hetojë ankesat e personave, të ndërmjetësojë, të japë mendime dhe rekomandime për raste të veçanta të diskriminimit;
-  jep mendim për projekt-aktet normative për mbrojtjen nga diskriminimi;
-  mbledh të dhëna statistikore dhe të tjera, kryen studime, kërkime dhe trajnime lidhur me diskriminimin;
-  bashkëpunon me partnerët socialë, organizatat joqeveritare të përfshira në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit heton ankesat e marranga çdo person fizik ose juridikë lidhje pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut sipas Kushtetutës, ligjit dhe akteve të tjera, si dhe instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet ose mosveprimet që përbëjnë shpërdorim të autoritetit.

Procedura për ankesa individuale pranë Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë ka shumë përparësi - është falas dhe e thjeshtë.

Kjo procedurë, e cila nuk kërkon asistencë ligjore profesionale, është edhe aspekti më i rëndësishëm i mbrojtjes nga diskriminimi që ofrohet nga individët në këtë institucion. Viktimat e diskriminimit, personat fizikë dhe juridikë mund të parashirojnë ankesat e tyre drejtpërdrejt duke kontaktuar Zyrën e Avokatit të Popullit (me postë, telefon, e-mail, faks ose personalisht), e cila, nëse është e nevojshme, i ndihmon në plotësimin e një formulari të veçantë.



THIRJA FALAS

0800 15555